



BANKA QENDRORE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS
CENTRALNA BANKA REPUBLIKE KOSOVA
CENTRAL BANK OF THE REPUBLIC OF KOSOVO

Identifikimi i Bankave me Rëndësi Sistemike dhe Kapitalit Shtesë në Kosovë

Krenare MALOKU BAKIJA dhe Arta NUSHI

Material Studimor Nr. 7

Material Studimor i BQK-së Nr. 7

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës

Krenare Maloku Bakija dhe Arta Nushi

Identifikimi i Bankave me Rëndësi Sistemike dhe Kapitalit Shtesë në Kosovë

Material për Diskutim i BQK-së

Identifikimi i Bankave me Rëndësi Sistemike dhe Kapitalit Shtesë në Kosovë

Krenare Maloku Bakija dhe Arta Nushi¹

Abstrakt

Kriza e fundit financiare ka theksuar rëndësinë e menaxhimit të rrezikut sistemik për sigurimin e stabilitetit financiar. Qëllimi i këtij punimi është adresimi i dimensionit strukturor dhe ndërsektoral të rrezikut sistemik që ndërlidhet me bankat me rëndësi sistemike. Në punim është avancuar modeli për identifikimin e BRS-ve për sektorin bankar të Kosovës dhe për herë të parë është kalibruar instrumenti për adresimin e këtyre institucioneve financiare me rëndësi sistemike, duke dhënë kështu kontribut funksionit të Politikës për Mbikëqyrje Makroprudenciale në Bankën Qendrore të Kosovës. Modeli për adresimin e rëndësisë sistemike është adaptuar në përputhshmëri me udhëzimet dhe kriteret bazë të propozuara nga Autoritetit Bankar Evropian, që përfshinë katër kriteret kryesore si madhësia, zëvendësueshmëria, kompleksiteti dhe aktiviteti ndërshtetërorë, si dhe ndërlidhshmëria. Rezultatet përgjithësisht kanë treguar qëndrueshmëri ndaj ndryshimit të peshave në kriteret e lartëcekura. Për adresimin e BRS-ve të identifikuara, është propozuar aplikimi i kapitalit shtesë sistemik deri në 1% të mjeteve të peshuara me rrezik. Materiali përfaqëson natyrë diskutuese rreth mundësisë që në të ardhmen një kërkesë për të aplikuar kapital shtesë do të paraqitej, dhe nuk përfaqëson propozim për ndërmarrjen e këtyre masave. Gjithashtu, materiali thekson rëndësinë e nxitjes së debatit rreth përfshirjes së kanalit 'informues' të shpërndarjes potenciale të problemeve në përcaktimin e rëndësisë sistemike të bankave në Kosovë.

JEL klasifikimi: E32, E44, E58, G01, G21

Fjalët kyçe: stabiliteti financiar, rreziku sistemik, bankat me rëndësi sistemike, kapitali shtesë sistemik, Kosova

Përmbajtja

I.	Hyrje	7
II.	Definimi dhe matja e rëndësisë sistemike	9
III.	Korniza rregullative e institucioneve me rëndësi sistemike	12
	3.1. Kërkesat për kapital shtesë	14
	3.2. Praktikrat e vendeve tjera të modeleve të IFRS-ve	16
IV.	Metoda për identifikimin e IFRS-ve në Kosovë	18
	4.1. Rezultatet	20
	4.2. Kapitali shtesë për absorbimin e humbjeve	22
V.	Përfundim	24
	Referencat	26

LISTA E FIGURAVE ----- 18

Figura 1. Kërkesat për kapital shtesë në bazë të kornizës Basel III-----	18
Figura 2. Rezultatet e tri metodave për matjen e rëndësisë sistemike-----	22
Figura 3. Norma e kapitalizimit-----	23
Figura 4. Shkalla e rëndësisë sistemike dhe alokimi i kapitalit shtesë-----	24

LISTA E TABELAVE----- 18

Tabela1. Praktikrat e vendeve tjera mbi vlerësimin e BRSV-e dhe aplikimi i kapitalit shtesë-----	18
Tabela 2. Kriteret dhe nënkriteret për matjen e rëndësisë sistemike-----	20
Tabela 3. Matrica e ndërlidhjes/korrelacionit ndërmjet të kriterëve për vlerësimin e rëndësisë sistemike-----	22
Tabela 4. Shkalla e kapitalit shtesë krahas shtrirjes së rëndësisë sistemike-----	24

Lista e shkurtesave

ABE	Autoriteti Bankar Evropian
BERS	Bordi Evropian për Rrezik Sistemik
BNN	Banka për Ndërmjetësime Ndërkombëtare
BQE	Banka Qendrore Evropiane
BRSV	Bankat me Rëndësi Sistemike Vendore
BSF	Bordi i Stabilitetit Financiar
FMN	Fondi Monetar Ndërkombëtarë
IFRS	Institucionet Financiare me Rëndësi Sistemike
KBMF	Komiteti i Bazelit për Mbikëqyrje Financiare
KK1	Kapitali i klasit të parë

Hyrje

Sektori financiar ka shënuar rritje të theksuar në dy dekadat e fundit, si rezultat i inovacioneve teknologjike të shumta si dhe derregullimit të sektorit. Tregjet financiare janë integruar globalisht duke krijuar rrethana për rritjen e aktivitetit dhe kompleksitetit të institucioneve financiare. Bankat, nga modeli tradicional i biznesit, kanë zgjeruar operacionet e tyre duke u përfshirë gjithnjë e më shumë në aktivitete të tregut dhe duke zgjeruar bazën e financimit dhe investimeve të tyre (Laeven et al., 2014). Me rritjen e aktivitetit dhe kompleksitetit të bankave, është rritur rëndësia e bankave në mbarëvajtjen e sektorit financiar për shkak të peshës së tyre dhe ndërlidhjes me institucione tjera financiare.

Kriza globale financiare e vitit 2008 theksoi rëndësinë e adresimit të rrezikut sistemik për shkak të pasojave të mëdha që pati kjo krizë në sektorin real. Shpejtësia dhe intensiteti me të cilën problemet financiare u përhapen nga një institucion financiar në tërë sektorin me pasoja të rënda për kreditimin e ekonomisë dhe më gjerë, vuri theksin në krijimin e politikave dhe rregullativave të reja që kanë për qëllim zvogëlimin e rrezikut sistemik. Politika dhe mbikëqyrja mikrofinanciare që për subjekt analize ka institucionet individuale u konsideruan si të pamjaftueshme për identifikimin e rrezikut sistemik dhe ruajtjen e stabilitetit financiar, duke vënë theksin në krijimin e mekanizmave të cilët adresojnë rrezikun në nivel makro të sektorit. Kjo i dha hov zhvillimit të Politikës Makroprudenciale me qëllim të krijimit të mekanizmave të cilët rrisin qëndrueshmërinë e sektorit financiar dhe parandalojnë akumulimin e rrezikut sistemik. Instrumentet e politikës makroprudenciale duhet të adresojnë rrezikun sistemik në tri dimensionet e tij: atë të kohës, me qëllim të parandalimit të akumulimit të mospërputhjeve të mëdha që rrisin rrezikun sistemik si dhe zbusin ciklin financiar; dimensionin ndër-sektoral, që synon rritjen e qëndrueshmërisë së sektorit dhe pengon efektin e shpërndarjes së problemeve ndërmjet institucioneve dhe sektorëve; si dhe dimensionin strukturorë, që inkurajon qasje më të përgjithshme ndaj rregullativave që krijojnë motivim adekuat të pjesëmarrsve të tregut (BQE).² Një ndër veglat që sugjerohet nga Banka për Ndërmjetësime Ndërkombëtare (angl: BIS) në kornizën rregullative të Baselit si dhe nga Bordi i Stabilitetit Financiar (angl: FSB) për identifikimin dhe adresimin e dimensionit ndër-sektoral dhe strukturorë të rrezikut sistemik është modeli i Institucioneve Financiare me Rëndësi Sistemike (IFRS). Modeli bazohet mbi parimin se institucionet të cilat janë më të mëdha, më komplekse në kuptimin e veprimtarisë dhe aktiviteteve si dhe janë më të ndërlidhura me institucione tjera financiare brenda dhe jashtë vendit, kontribuojnë më shumë në rrezikun sistemik, sidomos në rastet kur nuk janë mirë të kapitalizuara dhe bazohen në burime të paqëndrueshme të financimit (Laeven et al., 2014). Për të adresuar këtë problematikë si dhe rrezikun e sjelles jo-morale që ndërlidhet me institucionet e mëdha, janë ndërmarrë iniciativa rregullatore që kërkojnë aplikimin e shtesës së kapitalit bazuar në rëndësinë sistemike të bankave, si dhe kufizimin e aktiviteteve komplekse me rrezik të lartë. Megjithëse fokusi primar ishte në rregullimin e bankave me aktivitet global, Baseli dhe korniza evropiane legislative pranojnë që institucionet financiare mund të kenë rëndësi sistemike edhe në ekonomitë e brendshme, ndaj dhe mund të kenë nevojë për kapital shtesë për të absorbuar humbjet e mundshme në ekonomitë përkatëse.

Në vitin 2016, Banka Qendrore e Kosovës ka aprovuar Politikën për Mbikëqyrje Makroprudenciale e cila është draftuar konform kornizës makroprudenciale të Bordit Evropian për Rrezik Sistemik (angl: ESRB). Ndër instrumentet që do të përdorën për adresimin e rrezikut

² <https://www.ecb.europa.eu/ecb/tasks/stability/html/index.en.html>

sistemik është edhe shtesa e kapitalit për rëndësinë sistemike të institucioneve financiare në ekonominë e Kosovës. Në këtë studim, do të analizohet dhe zhvillohet modeli për identifikimin e IFRS-ve për sektorin bankar të Kosovës konform udhëzimeve të sugjeruara nga Autoriteti Bankar Evropian (angl: EBA), si dhe qasjet e mundshme rregullatore që Kosova mund t'i adaptoj për adresimin e institucioneve me rëndësi sistemike. Kontributi i këtij studimi është kalibrimi i modelit për sektorin bankar të Kosovës, i cili jep rekomandim për shtesën e nevojshme të kapitalit konform rëndësisë sistemike të bankave.

Punimi do të strukturohet si në vijim: pjesa e parë rishikon literaturën akademike rreth definicionit të IFRS-ve dhe qasjeve të ndryshme për identifikimin e rëndësisë sistemike. Pjesa e dytë paraqet kornizën rregullative ndërkombëtare për identifikimin e institucioneve financiare me rëndësi sistemike dhe përcaktimin e kërkesës për kapital shtesë absorbues. Pjesa e tretë analizon metodën për identifikimin e institucioneve me rëndësi sistemike në Kosovë dhe metodologjinë e vlerësimit të kapitalit shtesë absorbues konform rëndësisë sistemike. Në vijim paraqiten rezultatet e modelit për identifikim dhe përcaktim të kapitalit shtesë me të dhëna të dhjetorit 2016. Pjesa e katërt përfundon punimin duke ritheksuar qëllimin dhe rezultatet, si dhe duke paraqitur kufizimet dhe rekomandimet për punë shtesë.

I. Definimi dhe matja e rëndësisë sistemike

Kriza financiare e fundit ka shtuar dukshëm vëmendjen e akademikëve, hulumtuesve dhe institucioneve rregullatore në stabilitetin financiar. Ekziston konsensus i gjerë që në thelb të stabilitetit/destabilitetit financiar dhe politikave për sigurimin e qëndrueshmërisë financiare dhe zgjedhjen e krizave qëndron koncepti i 'rrezikut sistemik' dhe menaxhimi i tij.

Koncepti i rrezikut sistemik, ashtu sikurse koncepti i stabilitetit financiar, ka definime të shumta për shkak të natyrës shumë dimensionale të tij dhe dinamizmit të sistemit financiar, ndaj dhe nuk ka konsensus në atë se çfarë nënkupton ky koncept. Në përpjekje të definimit të tij, është me rëndësi të sqarohet ndarja mes rrezikut sistemik dhe rrezikut individual të institucioneve financiare. Rreziku individual i institucioneve financiare dhe dështimi individual i tyre për arsye të ekspozimit të lartë ndaj rreziqeve (rrezikut kreditor, likuiditetit, operacional, etj) apo keqpërdorimeve të brendshme, p.sh, nuk paraqet domosdoshmërit rrezik për tërë sektorin financiar sidomos në një sektorë financiar të kapitalizuar mirë. Ndërsa, rreziku sistemik është koncept më i gjerë që paraqet më shumë se vetëm përbërësit e rreziqeve individuale dhe nuk mund t'i atribuohet direkt një institucioni individual (Smaga, 2014). Rreziku sistemik nënkupton rrezikun që ndërveprimi i rreziqeve individuale mund të shkaktojë pasoja të papritura dhe të konsiderueshme për një pjesë të madhe të sektorit financiar që ka efekte negative të mëdha për tërë sektorin dhe ekonominë në tërësi. Në thelb të rrezikut sistemik qëndron 'efekti shpërndarës', i cili i referohet kanaleve përmes të cilave efektet negative barten nga një pjesë e sektorit financiar në tërë sektorin dhe më gjerë (De-Bandt dhe Hartmann, 2000). Sipas Dijkman (2010), këto kanale shpërndarëse klasifikohen në kanalet 'reale' të cilat nënkuptojnë bartjen e problemeve përmes ekspozimeve direkte të institucioneve ndërmjet vete (ekspozimi ndaj palëve të kundërta) dhe ndërlidhjes së tyre (sistemi i pagesave, instrumentet komplekse financiare), si dhe kanalin 'informues' i cili nënkupton shpërndarjen e problemeve si rezultat i ndërrimit të sjelljes së agjentëve ekonomikë (humbjes së besimit).

Banka Qendrore Evropiane definton rrezikun sistemik si rrezikun e paraqitjes së një ngjarje të rëndë sistemike që ndikon negativisht një numër të konsiderueshëm të institucioneve financiare sistemike apo tregjeve dhe infrastrukturës së ndërlidhur financiare. Shkalla e ashpërsisë së rrezikut sistemik dhe ngjarjes sistemike vlerësohet në bazë të efektit që vështirësitë në kryerjen e shërbimeve dhe shfrytëzimin e produkteve të nevojshme të sektorit financiar kanë në rritjen dhe mirëqenien ekonomike.³ Ekzistojnë variacione të shumta të definimit të rrezikut sistemik, por në përgjithësi, rreziku sistemik perceptohet si rreziku i një goditje negative që ka pasoja serioze për tërë sektorin financiar dhe ekonominë reale (Abdymomunov, 2013).

Sa i përket rëndësisë sistemike, institucione me rëndësi sistemike cilësohen ato institucione të cilat në rast të problemeve financiare apo falimentimit të çrregullt, janë në gjendje të materializojnë rrezikun sistemik për shkak të peshës që kanë në sektorin financiar, kompleksitetit të tyre si dhe ndërlidhjes sistemike (BSF, 2010). Nga perspektiva makroprudenciale, është e rëndësishme që të krijohet një definicion praktik i rëndësisë sistemike i cili i mundëson rregullatorit aplikimin e instrumenteve relevante për ndikimin e institucioneve financiare (Thomson, 2009). Një pjesë e konsiderueshme e literaturës trajton rëndësinë sistemike në kuptimin e ndikimit të madhësisë, kompleksitetit dhe ndërlidhjes në rrezikun sistemik (Silva et al. 2016). Rezultat empirike të shumta gjithashtu kanë argumentuar ndërlidhjen mes rrezikut

³ ECB Financial Stability Review December 2009.

<https://www.ecb.europa.eu/pub/fsr/shared/pdf/vbfinancialstabilityreview200912en.pdf?3f6f6891f874a3bd40cd00aef38c64f>

sistemik dhe madhësisë, kompleksitetit dhe ndërlidhshmërisë së institucioneve financiare (Laeven et al., 2014).

Sidoqoftë, matja e rëndësisë sistemike cilësohet si detyrë jo e thjeshtë për shumë arsye. Studimi krahasimor i masave kuantitative të matjes së rrezikut sistemik nga Biasis et al. (2012) sugjeron që definimet e rrezikut sistemik fokusohen në aspekte të ndryshme të këtij fenomeni kompleks dhe dinamik, ndaj dhe për këtë arsye ekzistojnë masa të shumta për matjen e tij prej disa perspektivave. Burimet e rrezikut sistemik janë të ndryshme dhe institucionet financiare mund të jenë të rëndësishme sistemikisht në disa mënyra, si p.sh për shkak të madhësisë së tyre dhe pjesëmarrjes në aktivitete kyçe si kreditimi dhe marrja e depozitave, për shkak të ndërlidhjes me palët e tjera, aktiviteteve të tyre komplekse apo për shkak të reputacionit dhe ndikimit në tregjet financiare. Për më tepër, përcaktimi i shkallës së rëndësisë sistemike është i vështirë ngase ekziston rreziku i mbi apo nën vlerësimit të rëndësisë sistemike. Vështirësia kryesore qëndron në përcaktimin e kufirit të rëndësisë sistemike: mbi vlerësimi i kufirit do të rezultonte në kufi të lartë të rëndësisë sistemike dhe rrezikun e mospërfshirjes së institucioneve që realisht kanë rëndësi sistemike. Ndërsa, nënvlerësimi i kufirit të rëndësisë sistemike mund të rezultojë në përfshirje të institucioneve të cilat nuk paraqesin rrezik sistemik. Në të dy rastet, do të zvogëlohej efikasiteti i politikave për adresimin e rrezikut sistemik, dhe do të krijoheshin neto humbje për ekonominë në përgjithësi (Elliott dhe Litan, 2011).

Kompleksitetit të matjes së rëndësisë sistemike i kontribuon edhe fakti që rëndësia sistemike nuk është koncept statik. Rëndësia sistemike e institucioneve të caktuara ndryshon varësisht prej rrethanave meqenëse efektet shpërndarëse të krizës përveç që ndikohen nga ekspozimi direkt dhe ndërlidhja e institucioneve, ato përshejtohen konsiderueshëm edhe përmes kanalit të informimit i cili ndikon sjelljen e pjesëmarrësve të agjentëve ekonomik (Dijkman, 2010). Në matjen e rëndësisë sistemike, është gjithashtu e rëndësishme që të mos krijohen motive të gabuara. Synimi duhet të jetë që të zvogëlohet rreziku i 'sjelljes morale' dhe probabiliteti i dështimit, por që lehtësisht mund të krijohen motivet për zvogëlimin e theksuar të madhësisë së bankave dhe aktiviteteve të tyre, gjë që nuk është e dëshirueshme dhe që në fakt mund të krijojë probleme në funksionimin e sektorit financiar dhe më tej. Andaj, procesi i matjes së rëndësisë sistemike duhet të bazohet në qasje të balancuar të kriterëve të rëndësisë sistemike dhe motiveve (balancojë kostot e mundshme sociale të krizës sistemike dhe kostot e profitit dhe kreditimit më të ulët si rezultat i rregullave të shtuara), përkundër vështirësive praktike për të arritur balance të tilla (Berg, 2011).

Qasjet për matjen e rëndësisë sistemike kryesisht grupohen në qasje të bazuar në të dhëna të tregjeve financiare apo qasje dinamike, si dhe qasje të bazuar në të dhëna nga bilanci i gjendjes së institucioneve financiare, apo qasja statike. Qasja e bazuar në të dhëna të tregjeve financiare aplikohet kryesisht nga akademikët dhe hulumtuesit, të cilët përdorin modele statistikore për të vlerësuar humbjet e mundshme të sistemit dhe kontributin e secilit institucion për të përcaktuar rëndësinë sistemike (sa më të larta humbjet aq më i rëndësishëm sistemikisht institucioni). Metoda tjera përdorin ekuacione sjellore ekonometrike për të simuluar ndikimin shpërndarës të krizës nga lidhjet mes institucioneve. Modelet e bazuara në qasje dinamike, sidoqoftë, kanë mangësi të shumta për faktin se jo të gjitha institucionet financiare janë të listuara në tregje dhe tregtojnë në baza të rregullta, andaj dhe treguesit financiarë nuk janë të disponueshëm. Gjithashtu, treguesit e tregjeve ndryshojnë shumë gjatë ciklit të biznesit dhe tentojnë të mbi po nën vlerësojnë efektet gjatë krizave (Berg, 2011 dhe Komárková et al., 2012).

Në anën tjetër, qasja statike është më e thjeshtë dhe stabile. Kjo qasje përdorë tregues kualitativ dhe kuantitativ që mundësojnë krahasimin dhe analizimin në detaje të komponentëve individual të sistemit. Është fleksibile, transparente dhe lehtë e komunikueshme, gjë që e bënë më praktike

për qëllime të politikës efektive makroprudenciale. Andaj, marrë parasysh këto përparësi, rregullatorët kanë përzgjedhur këtë qasje për adresimin e institucioneve me rëndësi sistemike në funksion të ruajtjes së stabilitetit financiar. Sidoqoftë, kjo qasje ka limitet e veta për shkak se kërkon gjykim arbitrar për të vendosur për kriteret për identifikim të rëndësisë sistemike, peshat e tyre si dhe nivelin krahasues apo kufirin e rëndësisë sistemike. Për këto arsye, si dhe vështirësitë tjera në matjen e rëndësisë sistemike të elaboruara më lartë, kërkohet që vlerësimi i rëndësisë sistemike të shoqërohet me nivel të lartë të gjyimit profesional, me theks të veçantë kur bëhet për qëllime të aplikimit të instrumenteve të politikës makroprudenciale në mënyrë që të sigurohet efikasitet i kësaj politike dhe të mos krijohen motivacione të gabuara.

II. Korniza rregullative e institucioneve me rëndësi sistemike

Institucionet Financiare me Rëndësi Sistemike (IFRS, angl.SIFI) duke qenë institucione që për shkak të madhësisë së tyre, kompleksitetit dhe ndërlikohjes financiare, dështimi i tyre do të kishte pasoja negative në sistemin financiar dhe aktivitetin ekonomik në përgjithësi, ka bërë që autoritetet mbikqyrëse të bankave të iu kushtojnë shumë vëmendje krijimit të kornizave rregullative për adresimin e tyre.

Masat e propozuara për të eliminuar ose reduktuar mundësinë e dështimit të këtyre institucioneve me rëndësi sistemike apo potencialin e tyre për të shkaktuar, në rast të dështimit, pasoja negative në funksionimin e sistemit financiar dhe të tërë ekonomisë, mund të grupohen në dy grupe (Bongini, 2014):

- 1) Masat preventive që përfshijnë rregullat prudenciale dhe strukturale, qëllimi i të cilave është parandalimi i rrezikut sistemik
- 2) Masat mbrojtëse që kanë për qëllim krijimin e procedurave kredibile në rast të jo-solvencës (insolvency) së bankave në mënyrë që të reduktojnë kostot e dështimit të institucioneve me rëndësi sistemike.

Autoritet rregullative, konkretisht Bordi i Stabiliteti Financiar (ang.FSB)⁴ dhe Komiteti i Bazelit për Mbikqyrje Bankare (ang.BCBS) kanë qasje më prudenciale për adresimin e rrezikut sistemik dhe rrezikut të sjelljes morale (moral hazard) që rrjedhin nga këto institucione me rëndësi sistemike apo të ashtuquajturat “shumë të mëdha për të dështuar” (too big too fail). Masat prudenciale kanë për qëllim që të reduktojnë mundësinë e dështimit të institucioneve financiare përmes aplikimit të kërkesave rregullatore si dhe mbikqyrjes më strikte të këtyre institucioneve. Sidoqoftë, trajtimi i IFRS-ve kërkon një qasje sa më të integruar dhe më afatgjate që kombinon masat preventive si dhe ato mbrojtëse.

Në samitet e fundit të mbajtura nga Liderët e G20⁵ është kërkuar nga BSF që të krijohet një kornizë e politikave dhe masave rregullative për të adresuar rrezikun sistemik dhe për të reduktuar rrezikun e sjelljes morale nga IFRS-të. Implementimi i këtyre politikave ka filluar që nga viti 2012 dhe pritet të përfundojnë plotësisht në vitin 2019 (FSB, 2011).⁶

Masat rregullatore të aprovuara nga autoritet BSF dhe KBMB përmbledhen në tri grupe veprimesh rregullative:

i) Parimet kryesore për regjim efektiv të shpëtimit të Institucioneve Financiare (FSB, 2011).

Qëllimi i këtyre masave të hartuara nga BSF është shpëtimi i institucioneve financiare me probleme, duke mos krijuar rrezik të funksionimit të rregullt të sistemit financiar dhe duke mos i ngarkuar taksapaguesit për shpëtimin e tyre. Në të njëjtën kohë, këto masa synojnë që të mbrojnë funksionimin e ekonomisë përmes mekanizmave ku bartja e humbjeve nga likuidimi i një institucioni të bëhet në respektim të hierarkisë duke filluar nga aksionarët, tek kreditorët e pasiguruar dhe me radhë.

⁴ Shkurtesat e Institucioneve financiare janë lënë në gjuhën angleze, në shumicën e rasteve, për shkak se janë të familjarizuara si të tilla në përdorim në komunitetin e financave dhe më gjerë.

⁵ Argentina, Australia, Brazil, Canada, China, France, Germany, India, Indonesia, Italy, Japan, Republic of Korea, Mexico, Russia, Saudi Arabia, South Africa, Turkey, the United Kingdom, the United States and the European Union.

⁶ Policy measure to address SIFI (FSB, 2011).

Parandalimi dhe zbutja e krizës financiare kërkon plan për dalje nga kriza (që mbulohen nga ana e bankave) dhe plane për zgjidhje të krizës (që mbulohen nga autoritetet). Plani për dalje nga kriza përmes “kapitalit shtesë” dhe regjimi për zgjidhje të krizës (resolution regime) janë politika që e komplementojnë njëra tjetrën me qëllim të sigurimit të kontinuitetit të funksionimit të sistemit financiar. Prandaj kërkesa për kapital shtesë është politikë ex-ante që e komplimenton politikën ex-post të regjimit të daljes nga kriza (ESRB, 2013). Për dallim nga shtesat e kapitalit që propozohen nga Bazeli, të cilat kanë për qëllim vazhdimësinë e aktivitetit të institucioneve financiare të goditura nga kriza, qëllimi i zgjidhjes së krizës (resolution regime) ka për qëllim që nëse një bankë detyrohet të falimentojë, atëherë ky proces të bëhet me rregulla që e sigurojnë funksionimin e disa aktiviteteve kyçe të bankës, në mbrojtje të stabilitetit financiar dhe duke mos ngarkuar fondet publike për daljen nga kriza (Bank of England, 2016).⁷

ii) **Bankat me Rëndësi Sistemike – Metodologjia e vlerësimit dhe identifikimit të rëndësisë sistematike si dhe kërkesat për kapital shtesë për absorbim të humbjeve, (BIS, 2013).**

KBMB ka përpiluar rregulloren mbi kriteret e përcaktimit të institucioneve me rëndësi sistematike në nivel global dhe modalitetet për kalibrimin e kapitalit shtesë absorbues që bankat me rëndësi sistematike duhet të mbajnë.

Kjo rregullore përcakton kërkesat për kapital shtesë mbi nivelin rregullator për institucionet e identifikuara me rëndësi sistematike, me qëllim që të zvogëlohet rreziku i sjelljes morale si dhe të rritet kapaciteti i tyre për absorbim të humbjeve në rast të ndonjë krize. Qëllimi i kapitalit shtesë është që të zvogëlojë mundësitë e dështimit të ndonjë institucioni dhe për më tepër ky nivel kapitali synon të dekurajoj IFRS që të hyjnë në aktivitete që do të ndikonin në rritjen e rrezikut sistematik (Bongini, 2014).

Po ashtu, Komiteti i Bazeli ka hartuar kriteret dhe udhëzimet për përcaktimin e bankave me rëndësi sistematike në nivel vendor, që komplementon rregulloren mbi IFRS në nivel global. Për implementimin e kësaj rregullore është mandatuar ABE, e cila në bazë të parimeve të përcaktuara nga Bazeli nxjerrë udhëzime mbi kriteret për identifikimin e institucioneve me rëndësi sistematike dhe përcaktimin e nivelit për mbajtje të kapitalit shtesë konform rëndësisë sistematike të këtyre institucioneve. Numër i konsiderueshëm i vendeve kanë njoftuar dhe disa nga to kanë filluar aplikimin e kapitalit shtesë mbi nivelin rregullator sipas rëndësisë sistematike të bankave në vend.

iii) **Parimet për mbikëqyrje të intensifikuara dhe efektive të bankave me rëndësi sistematike, (FSB, 2011).**


Mbikëqyrje më e intensifikuara dhe më e efektshme është komponentja tjetër kryesore e rregullave të Bordit të Stabilitetit Financiar që synon reduktimin e rrezikut moral që paraqitet nga IFRS-të. Këtu përfshihen vlerësimet bazuar në gjykimet profesionale të autoritetit mbikëqyrës që mund të bazohen edhe në informata kualitative, atëherë kur disa informata nuk mund të sigurohen lehtësisht nga indikatorët kuantitativ. Një shembull i tillë mund të jetë ristrukturimi i operacioneve bankare (FSB, 2011).

⁷ The Financial Policy Committee's framework for the systemic risk buffer, BoE 2016.

2.1. Kërkesat për kapital shtesë

Reformat në kornizën rregullative të sektorit financiar përfshijnë ndryshime në kërkesat për kapital, apo shtesa të ndryshme të kapitalit për adresimin e rrezikut sistemik në tri dimensionet e tij (kohorë, strukturorë dhe dimensionin ndër-sektoral). Kërkesat e reja për kapital që duhet të përmbushen deri në vitin 2019 sipas kornizës ndërkombëtare rregullative për bankat - nga Bazel, janë të paraqitura në figurën 1. ‘Kapitali shtesë’ është instrumenti i cili trajton dimensionin strukturorë dhe ndër-sektoral të rrezikut sistemik i cili matet përmes rëndësisë sistemike të institucioneve financiare, dhe i cili është subjekti i kësaj analize.

Figura 1. Kërkesat për kapital shtesë në bazë të kornizës Basel III



Burimi: Banka e Francës (2017)

Ky instrument ka për qëllim reduktimin e mundësisë së një rreziku sistemik, përmes rritjes së kapacitetit për absorbimin e humbjeve nga dështimi i mundshëm i tyre. Oponentët e aplikimit të kapitalit shtesë argumentojnë që rritja e kërkesës për kapital shtesë për bankat dhe institucionet e tjera me rëndësi sistemike është e kushtueshme gjë e cila do të ndikonte në aktivitetin e bankës duke pasur më pak hapësirë për rritje të kreditimit që rrjedhimisht do të ndikonte në ngadalësim të rritjes ekonomike. Po ashtu identifikimi i institucioneve me rëndësi sistemike mund të rrisë rrezikun e sjelljes morale të këtyre institucioneve pasi që këto të fundit, si dhe

publiku i gjerë, de facto njoftohen se këto institucione janë “shumë të mëdha për të dështuar”, dhe në rast të dështimit të tyre si autoritet mbikëqyrëse ashtu edhe qeveria do tu ofrojnë fonde për shpëtim (Komárková et al., 2012). Ndërsa argumentet pro kërkesës për kapital shtesë theksojnë se kapitali shtesë do të rriste nivelin e burimeve të financimit të IFRS-ve të cilat nuk do t'i kishin po qe se do të konsideroheshin nga të gjithë “shumë të rëndësishme për të dështuar”.

Sikurse që procesi i identifikimit të institucioneve financiare me rëndësi sistemike cilësohej proces kompleks dhe sfidues, ashtu edhe përcaktimi i nivelit adekuat të kapitalit shtesë deri në atë masë sa e redukton mundësinë e dështimit të një IFRS-je paraqitet të jetë mjaft sfiduese. Niveli adekuat i kapitalit shtesë duhet të jetë aq sa i stimulon IFRS-të për tu mos u angazhuar në aktivitete që bartin rrezik më të lartë se që japin përfitime për zhvillim ekonomik. Niveli adekuat i kapitalit shtesë apo mbingarkesës me kapital duhet të përcaktohet si ‘trade-off’ në mes të kostos ekonomike që do të shkaktohej nga rritja e nivelit të kërkuar të kapitalit në periudhat e jo krizës financiare dhe benefiteve të rregullimit me qëllim të reduktimit të kostove ekonomike në periudha të krizës financiare (Komárková et al., 2012). Berg (2011) në punimin e tij paraqet problemet e llogaritjes së kapitalit shtesë duke theksuar që institucionet me rëndësi sistemike zakonisht shpëtohen nga falimentimi prandaj shumë shpesh shpenzimet e veprimeve të shpëtimit nga falimentimi nuk konsiderohen. Për këtë arsye Komiteti i Bazelit në rekomandimin për kapital shtesë ka konsideruar atë nivel të kapitalit që do të mund të absorbonte humbjet e shkaktuara nga problemet e një IFRS-je. Modelet kuantitative të ndërmarra nga Komiteti i Bazelit kanë dhënë një rezultat prej 1-8% të raportit të kapitalit të klasit të parë ndaj asetëve të peshuara me rrezik, megjithatë rekomandimi final qëndron në nivel 1-3.5% të asetëve me rrezik, që është konsideruar e mjaftueshme për absorbim të humbjeve kur kapitali i klasit të parë është i kualitetit të lartë. Efektet pozitive në stabilitetin financiar nga ngarkesa e IFRS-ve me kapital shtesë janë konsideruar shumë më të mëdha se sa kostot ekonomike të kësaj ngarkese (SRB, 2013).

KBMB (ang. BCBS) në nëntor të vitit 2011 ka publikuar rregulloren mbi metodologjinë e vlerësimit të bankave me rëndësi sistemike globale (BRS-G, ang. G-SIB) dhe kërkesat për kapital shtesë për absorbimin e humbjeve. Korniza rregullatore e BRS-G matë rëndësinë sistemike të bankave bazuar në 5 kritere të cilat përfshijnë 12 indikatorë. Kufiri i rëndësisë sistemike për BRS-G është 130 pikë bazë, ku çdo bankë që do të rezultonte me vlerë mbi 130 pikë bazë do të konsiderohej bankë me rëndësi sistemike. Kapitali shtesë për absorbimin e humbjeve të mundshme nga goditjet e krizave përcaktohet në shtrirje prej 1%-3.5% krahas rëndësisë sistemike të këtyre institucioneve, ku niveli maksimal prej 3.5% mbetet i paaplikuar me qëllim që të dekurajojë bankat për tu angazhuar në aktivitete që mund të rrisin rrezikun e tyre sistemik (BIS, 2013).

G20 ka kërkuar nga KBMB dhe BSF që po ashtu të krijojnë modalitet për bankat me rëndësi sistemike në nivel vendor (BRS-V, ang. domestic systemically important banks D-SIB). BRS-V është kornizë komplementare e kornizës së BRS-G që fokusohet në ndikimin e dështimit të një banke në stabilitetin financiar dhe ekonominë e brendshme. Komiteti i Bazelit kërkon që vlerësimi i bankave me rëndësi sistemike në vend të bëhet nga autoritetet mbikëqyrëse në përputhje me 12 parimet, nga të cilat 7 për vlerësimin dhe identifikimin e bankave me rëndësi sistemike në vend dhe 5 të tjera për kalibrimin e kapitalit shtesë për absorbimin e humbjeve nga dështimi i mundshëm i tyre (BIS, 2012). Ekuivalenti i kësaj kornize rregullatore për bankat me rëndësi sistemike në vend (BRS-V) është korniza për “identifikimin e institucioneve të tjera me rëndësi sistemike”. Për këtë kornizë ABE ka mandat që në përputhshmëri me 12 parimet e përpiluara nga Komiteti i Bazelit tek korniza rregullative për identifikimin e BRS-V, të nxjerrë

udhëzime për vendet anëtare të Unionit Evropian mbi kriteret për identifikimin e institucioneve të tjera me rëndësi sistemike (IFRS-T) dhe përcaktimin e nivelit për mbajtje të kapitalit shtesë konform rëndësisë sistemike të këtyre institucioneve.

Metodologjia e udhëzimeve të ABE kërkon nga autoritetet mbikëqyrëse që të vlerësojnë rrezikun sistemik që mund të shkaktohet nga institucionet me rëndësi sistemike, duke ofruar qasje përmes dy hapave: autoritet relevante vlerësojnë institucionet (përfshirë këtu edhe institucione tjera financiare përveç bankave) përmes katër kriterëve për matje të rëndësisë sistemike, që janë: madhësia, ndërlidhshmëria, zëvendësueshmëria dhe aktiviteti ndërshtetëror/kompleksiteti, të cilat përmbajnë indikatorët e përcaktuar sipas specifikave të sektorit bankar në vend dhe të cilat reflektojnë ndikimet potenciale në stabilitetin financiar në vend. ABE kërkon nga autoritetet që institucionet e identifikuar me rëndësi sistemike ti ngarkojnë me kapital shtesë për absorbimin e humbjeve në nivele prej 0% deri në 2% të mjeteve me rrezik, kalkuluar krahas rrezikshmërisë së tyre sistemike, dhe nën juridiksionin e plotë të vendeve përkatëse për përcaktimin e nivelit maksimal të kapitalit shtesë. Identifikimi dhe përcaktimi i kapitalit shtesë ka filluar në vitin 2015 dhe rishikohet në baza vjetore. Hapi i dytë është kontrollimi i mëtutjeshëm i institucioneve që nuk janë identifikuar me rëndësi sistemike, por që mund të kenë specifika dhe ndikime të konsiderueshme në stabilitetin financiar të vendit specifik. Ky vlerësim bëhet përmes faktorëve kuantitativ dhe kualitativ bazuar në gjykim profesional të autoritetit mbikëqyrës në vendet përkatëse (EBA, 2014).

2.2. Praktikrat e vendeve tjera të modeleve të IFRS-ve

Bankat Qendrore të vendeve anëtare të Bashkimit Evropian janë të obliguara që në baza të rregullta të identifikojnë institucionet me rëndësi sistemike bazuar në rregullat e Bazel-it dhe kornizën legjislativë evropiane (direktivave për kërkesa të kapitalit CRR/CRD IV).⁸ Institucionet financiare me rëndësi sistemike vendore, në varësi të diskrecionit të vendeve përkatëse, kërkohet të aplikojnë masat plotësuese lidhur me shumën e Kapitalit të Klasit të Parë që ata duhet të mbajnë si shtesë konform shkallës së tyre sistemike. Këto shtesa të kapitalit, siç është elaboruar më lartë, synojnë që të adresojnë efektet e mundshme negative që këto institucione mund të shkaktojnë në sistemin financiar të vendit dhe më gjerë.

Më poshtë kemi paraqitur praktikrat e vendeve të Bashkimit Evropian të cilat janë të obliguara të ndjekin udhëzimet e ABE-së për identifikimin e bankave me rëndësi sistemike në vend. Disa prej tyre përveç kriterëve të obliguara (madhësia, ndërlidhshmëria, zëvendësueshmëria, aktiviteti ndërshtetëror dhe kompleksiteti) konsiderojnë edhe gjykimin subjektiv të ekspertëve për një vlerësim më të saktë të bankave që kanë rëndësi sistemike varësisht prej rrethanave vendore dhe specifikave të sektorëve bankar përkatës. Përjashtim bënë Mbretëria e Bashkuar, e cila përdorë metodologji alternative për përcaktimin e rëndësisë sistemike, e cila bazohet vetëm në kriterin e madhësisë së asetëve dhe vlerësim subjektiv të ekspertëve.

Vendet e rajonit, Maqedonia dhe Serbia, gjithashtu kanë nxjerrë vendime për aplikimin e shtesës së kapitalit për rëndësinë sistemike vendore. Vlerësimi i rëndësisë sistemike nga këto vende është bërë konform udhëzimeve të ABE-së.

Në tabelën e mëposhtme shihet që kufiri i rëndësisë sistemike është përcaktuar brenda kufijve të dhënë në udhëzimet e ABE-së (275-375 pikë bazë). Për disa vende, si p.sh vendet e rajonit të cilat edhe kanë sektorë bankar me ngjashmëri më të madhe me atë të Kosovës, nuk janë shpalosur detajet rreth kufirit të rëndësisë sistemike që është përdorur. Shtesa e kapitalit që është përdorë

⁸ CRR – Capital Requirements Regulation; CRD – Capital Requirements Directive.

nga disa vende tejkalon kufirin prej 2% të KK1 për shkak të fleksibilitetit në rregullativën e kërkesave për kapital, më konkretisht për shkak të lejimit të aplikimit të shtesës së kapitalit për rrezik sistemik (Systemic Risk Buffer)⁹ e cila mund të arrijë deri në 5% të KK1.

Afati për implementimin e plotë të shtesës së kapitalit është vendosur viti 2019, sipas rregullativës evropiane. Shumica e vendeve kanë filluar aktivizimin e masës nga viti 2016, për të siguruar proces gradual të përshtatjes. Megjithatë disa shtete kanë vendosur që aktivizimin e masave të kapitalit ta bëjnë në vitet e mëvonshme, dhe disa të tjera kanë shtrirë afatin e implementimit të plotë në vitin 2020.

Tabela 1. Praktikrat e vendeve tjera mbi vlerësimin e BRSV-e dhe aplikimi i kapitalit shtesë

Shteti	Kriteret për vlerësimin e bankave me rëndësi sistemike vendore (BRSV)	Shtesa e kapitalit për BRSV (si % e Aseteve të Peshuara me Rrezik)	Data e aplikimit/Implementimit të plotë
Bullgaria	Udhëzimet e Autoritetit Bankar Evropian.	0.0% - 1.0% KK1 Kufiri i rëndësisë sistematike: 275 pikë bazë	Aktivizimi më 1 janar 2017; Implementimi i plotë më 2020
Kroacia	Udhëzimet e Autoritetit Bankar Evropian, si dhe vlerësimi/gjykim mbikqyrës (një institucion në kufi të rëndësisë sistematike është klasifikuar si sistemik pas vlerësimit mbikqyrës).	0.2% - 2.0% KK1, e kalibruar në bazë të metodës 'equal expected impact'. Kufiri i rëndësisë sistematike: 275 pikë bazë	Aktivizimi dhe implementimi i plotë më 31 dhjetor 2016
Gjermania	Udhëzimet e Autoritetit Bankar Evropian, si dhe vlerësimi/gjykim mbikqyrës.	0.5% - 2.0% KK1 Kufiri i rëndësisë sistematike: 350 pikë bazë	Aktivizimi më 1 janar 2017; Implementimi i plotë më 2019
Hungaria	Udhëzimet e Autoritetit Bankar Evropian ku janë shtuar edhe disa indikatorë opsional relevant për specifikat e sektorit bankar të vendit (derivativat valutore, etj), si rezultat i vlerësimit/gjykim mbikqyrës.	0.5% - 2.0% KK1	Aktivizimi më 1 janar 2017; Implementimi i plotë më 2020
Islanda	Udhëzimet e Autoritetit Bankar Evropian: Madhësia; Zëvendësueshmëria; Ndërlidhja dhe Kompleksiteti, si dhe një indikator tjetër (transaksionet valutore) është përdorur për të reflektuar rëndësinë e tregut të këmbimeve valutore në ekonominë e Islandës.	2.0% KK1 (maksimumi për të tri bankat meqenëse kanë nivel të rëndësisë sistematike shumë më të lartë se kufiri prej 350 pikëve bazë). Kufiri i rëndësisë sistematike: 350 pikë bazë	Aktivizimi 1 prill 2016
Macedonia	Udhëzimet e Autoritetit Bankar Evropian: Madhësia; Zëvendësueshmëria; Ndërlidhja dhe Kompleksiteti.	1.0% - 3.5% KK1	Aplikimi i pjesërishtëm (gjysma e kapitalit) deri më 30 shtator 2017. Aplikimi i tërësishtëm deri më 31 Mars 2017
Malta	Metodologji vendore e komplementuar me vlerësim/gjykim mbikqyrës. Është aplikuar gjithashtu metodologjia e Autoritetit Bankar Evropian dhe ka pasur rezultate të njëjta.	0.5% - 2.0% KK1	Aktivizimi më 1 janar 2016; Implementimi i plotë më 1 janar 2019
Mbrotëria e Bashkuar	Madhësia (gjithsej asetet) e bankave dhe shoqërive të ndërtimit që janë subjekt i ndalimit të përfshirjes në aktivitetet e tregut (ring-fenced); Autoriteti Rregullativ Prudencial mund të përdorë gjykimin e vlerësuesit për ndërhyrje.	0 - 3.0% KK1 Kufiri i rëndësisë sistematike: £175 miliardë vlera e asetëve	Implementimi i plotë më 1 janar 2019
Republika Çeke	Udhëzimet e Autoritetit Bankar Evropian, si dhe vlerësimi/gjykim mbikqyrës në pajtueshmëri me nenin 13 të udhëzimeve të ABE.	1.0% - 3.0% KK1 (kapital shtesë i rrezikut sistemik) Kufiri i rëndësisë sistematike: 425 pikë bazë	Aktivizimi më 1 janar 2017; Nuk ka afat përfundimtar implementues. Republika Çeke përdor shtesën e kapitalit sistemik për të zburuar rrezikun strukturor që kanoset nga bankat me rëndësi sistematike
Rumania	Udhëzimet e Autoritetit Bankar Evropian, si dhe vlerësimi/gjykim mbikqyrës.	0.0% - 1.0% KK1 Kufiri i rëndësisë sistematike: 275 pikë bazë	Aktivizimi dhe implementimi i plotë më 1 mars 2017
Slovakia	Udhëzimet e Autoritetit Bankar Evropian.	0.0% - 2.0% KK1 Kufiri i rëndësisë sistematike: 425 pikë bazë (për shkak të numrit relativisht të vogël të bankave)	Implementimi i plotë më 1 janar 2018
Slovenia	Udhëzimet e Autoritetit Bankar Evropian.	0.25% - 1.00% KK1 Kufiri i rëndësisë sistematike: 350 pikë bazë	Aktivizimi nga 1 janar 2016. Aplikimi i tërësishtëm më 1 Janar 2019

Burimi: : Bordi Evropian për rrezik sistemik (2017)

⁹ Shih figurën nr. 1 më lartë për kërkesat për kapital shtesë.

III. Metoda për identifikimin e IFRS-ve në Kosovë

Sektori financiar i Kosovës është kryesisht i bazuar në banka, të cilat përbëjnë afër 70 përqind të sektorit financiar. Andaj, modeli për identifikimin e institucioneve me rëndësi sistemike analizon vetëm bankat. Në identifikimin e bankave me rëndësisë sistemike në Kosovë, tashmë janë përdorur disa modalitete të qasjes statike, të cilat kanë përdorur tregues të ndryshëm për vlerësimin e rëndësisë sistemike të bankave që operojnë në Kosovë.

Fillimisht janë konsideruar tri kritere kryesore, si madhësia, zëvendësueshmëria dhe ndërlidhja, të cilat janë peshuar sipas vlerësimit relativ të rëndësisë së tyre.¹⁰ Kriterit të madhësisë i është dhënë pesha më e madhe me 40 përqind, dhe është vlerësuar përmes tetë nëntreguesve me peshë të barabartë. Kriteri i zëvendësueshmërisë dhe ai i ndërlidhjes janë vlerësuar të kenë peshë nga 20 përqind secili, dhe janë vlerësuar përmes shtatë dhe tre nëntreguesëve, respektivisht.

Modeli i rëndësisë sistemike është modifikuar në vazhdimësi për të iu përshtatur ndryshimeve në kornizën rregullative dhe udhëzuese ndërkombëtare, si dhe për të avancuar në përzgjedhjen e treguesve për matjen e kritereve përkatëse në përpjekje për të vlerësuar sa më drejtë rëndësinë sistemike të bankave. Modeli i radhës, i bazuar në kornizën për adresimin e bankave vendore me rëndësi sistemike të Komitetit të Bazelit për Mbikëqyrje Bankare të vitit 2012 si dhe në modelin paraprak të BQK-së, përfshiu edhe kriterin e katërt që përfaqësonte kompleksitetin e bankave.¹¹ Për shkak të specifikave të sektorit bankar në Kosovë, dy kriteret e para si ai i madhësisë dhe zëvendësueshmërisë u vlerësuan me peshë dominante nga 40 përqind, ndërsa kriteri i ndërlidhshmërisë dhe kompleksitetit me peshë nga 10 përqind. Treguesit brenda kritereve pësuan ndryshime të vogla, ndërsa metodologjia e vlerësimit mbeti e ngjashme, duke vlerësuar rëndësinë sistemike për treguesit në bazë të krahasimit të tyre me mesataren e sektorit për treguesit përkatës.

Ndryshimi i radhës i modelit të bankave me rëndësi sistemike ishte më substancial për faktin se avancon në përzgjedhjen e treguesve për vlerësimin e kritereve, duke eliminuar mbivendosjen e informacionit si dhe thjeshtëson procesin e vlerësimit si rezultat i zvogëlimit të numrit të treguesve në 11 nga 17 sa ishin më parë. Për më tepër, modeli shton edhe një kriter shtesë, atë të aktivitetit ndërshtetërorë, për të vlerësuar mundësinë e rritjes së rrezikut sistemik si rezultat i ekspozimit ndaj institucioneve financiare jashtë vendit. Pesha e kritereve mbeti e ngjashme mbi argumentin që sektori i Kosovës është i thjeshtë dhe shkalla e ndërlidhjes, kompleksitetit dhe ekspozimit ndërshtetërorë mbetet e vogël.¹²

Së fundmi, modeli i Identifikimit të Bankave me Rëndësi Sistemike është modifikuar për t'iu përshtatur udhëzimeve të Autoritetit Evropian Bankar të publikuar në vitin 2014. Përparësia e këtij verzioni është se standardizon mënyrën e vlerësimit me kornizën rregullative evropiane dhe vendet anëtare të Bashkimit Evropian dhe lehtëson krahasimin. Kriteret e vlerësimit, sipas këtij modeli, reduktohen në katër, duke bashkuar kriterin e aktivitetit ndërshtetërorë me atë të kompleksitetit. Pesha e kritereve është e barabartë, gjë që redukton hapësirën për subjektivitet si dhe eliminon mundësinë e nënvlerësimit të rrezikut si pasojë e evoluimit të sektorit dhe rritjes së rëndësisë në kriteret të cilave në vazhdimësi iu është dhënë më pak rëndësi (ndërlidhjes dhe kompleksitetit/aktivitetit ndërshtetërorë). Përzgjedhja e treguesve për kriteret përkatëse është

¹⁰ Modeli fillestar i BQK-së për identifikimin e IFRS është bazuar në punimin e Kastrati, A. (2012). "Identifikimi i Bankave me Rëndësi Sistemike në Kosovë", të publikuar në Raportin e Stabilitetit Financiar Nr.3 të BQK-së.

¹¹ Identifikimi i Bankave me Rëndësi Sistemike, Raporti i Stabilitetit Financiar Nr.4, fq. 61.

¹² Identifikimi i Bankave me Rëndësi Sistemike, Raporti i Stabilitetit Financiar Nr.9, fq. 75.

bërë konform teorive përkatëse dhe sugjerimeve të kornizës mbi të cilin është zhvilluar ky model, duke iu përshtatur rrethanave (disponueshmërisë me të dhëna).

Vlerësimi i rëndësisë sistemike/notimi bëhet në raport me kufirin e paracaktuar të rëndësisë sistemike. Një bankë konsiderohet me rëndësi të përgjithshme sistemike nëse mesatarja e peshuar e të gjitha kriterëve për bankën përkatëse tejkalon kufirin e rëndësisë sistemike, që në rastin e Kosovës devijon nga udhëzimet e ABE-së, ku kufiri i rëndësisë sistemike sugjerohet të jetë brenda intervalit 275-375 pikë bazë. Arsyeja pse në rastin e Kosovës kufiri i rëndësisë sistemike vendoset më lartë, përkatësisht në nivelin e mesatares së sektorit për të gjitha kriteret, është sepse sektori bankar në Kosovë përfshinë numër të vogël të bankave për dallim nga vendet e BE-së andaj dhe pjesëmarrja e aktivitetit të bankave më të vogla në gjithsej aktivitetin e sektorit është shumë më e lartë se në vendet me sektorë më të zhvilluar. Andaj, vendosja e kufirit të rëndësisë sistemike në nivelin të ulët siç rekomandohet nga ABE nuk është adekuat ngase rezulton që të gjitha bankat dhe degët bankare që operojnë në Kosovë të kenë rëndësi të përgjithshme sistemike. Kufiri i rëndësisë sistemike për rastin e Kosovës është vlerësuar të jetë 1,000 pikë bazë, dhe bankat, mesatarja e kriterëve të së cilave rezulton më e lartë se kjo shkallë, konsiderohen banka më rëndësi sistemike.

Tabela 2. Kriteret dhe nënkriteret për matjen e rëndësisë sistemike

Kriteri	Idikatorët
Madhësia (peshë 25%)	Asetet (pa provizione) dhe zërat jashtë bilancor
Zëvendësueshmëria (peshë 25%)	Numri i transaksioneve në raport me gjithsej transaksionet përmes sistemit të pagesave Pjesëmarrja e kreditë për konsum të ekonomive familjare Pjesëmarrja e kredive për korporatat jo financiare Pjesëmarrja e depozitave të ekonomive familjare
Ndërlidhshmëria (peshë 25%)	Pjesëmarrja e kredive për korporatat tjera financiare dhe plasmaneve në bankat tjera (duke mos përfshirë bankat amë) Pjesëmarrja e depozitave të korporatave tjera financiare dhe huazimeve tjera (duke përfshirë edhe depozitat e bankave tjera) Pjesëmarrja në letrat me vlerë
Aktiviteti ndërshtetëror dhe Kompleksiteti (peshë 25%)	Kërkesat ndaj sektorit të jashtëm Detyrimet ndaj sektorit të jashtëm Pjesëmarrja e zërave jashtë-bilancor

Burimi: BQK (2017)

Kriteri i madhësisë, konsiderohet kriter shumë i rëndësishëm në matjen e rëndësisë sistemike të një institucioni, pasi që sa më e madhe të jetë pjesëmarrja e një banke në gjithsej sektorin, aq më e madhe do të jetë rëndësia e saj sistemike. Kjo pasiqë palët e ndikuara në rast të tronditjeve në këtë bankë janë më të shumta dhe kostot për tërë sektorin dhe ekonominë janë më të mëdha. Madhësia e institucioneve matet si raport i aseteve të secilit institucion ndaj gjithsej aseteve të sektorit.

Kriteri i zëvendësueshmërisë matë shkallën e zëvendësueshmërisë së ofrimit të produkteve dhe shërbimeve të bankës përkatëse nga bankat tjera në treg, në rast të dështimit të saj. Sa më e madhe pjesëmarrja e një banke në një segment të caktuar të tregut apo në ofrimin e një lloji të caktuar të shërbimit, aq më të larta janë kapacitetet teknike dhe njohuritë për funksionim në sektorin përkatës (p.sh. të sistemit të pagesave), gjë që e bëjnë më të vështirë zëvendësimin e rolit të saj në ofrimin e këtyre shërbimeve bankare. Andaj, edhe rëndësia sistemike e një institucioni rritet kur vështirësitë për zëvendësimin e ofrimit të shërbimeve dhe produkteve të saj janë më të mëdha.

Kriteri i ndërlidhshmërisë ka për qëllim që të masë shkallën e ndërlidhshmërisë ndërmjet institucioneve bankare si dhe ndërlidhshmërisë me institucionet tjera financiare në vend në mënyrë që të identifikojë rrezikun e efektit shpërndarës së krizës së një institucioni tek institucionet tjera financiare dhe tek sektori real. Ky kriter është i një rëndësie të veçantë për matjen e rrezikut sistemik në vendet me sektorë të zhvilluar financiar ku ndërlidhjet mes institucioneve janë të shumta dhe komplekse. Në Kosovë, tregu ndërbankar është në nivel shumë të ulët të aktivitetit dhe ndërlidhjet mes institucioneve financiare kryesisht kufizohen në depozitat dhe kreditë që institucionet tjera financiare si kompanitë e sigurimeve, institucionet mikrofinanciare dhe ndihmësit tjerë financiar mbajnë në bankat komerciale në vend. Rrjedhimisht, ndërlidhja mes institucioneve financiare matet përmes pjesëmarrjes së plasmanëve në bankat tjera dhe ekspozimit kreditor ndaj korporatave tjera financiare, si dhe pjesëmarrjes së depozitave dhe huamarrjeve nga korporatat tjera financiare. Në këtë kriter janë përfshirë edhe investimet në letra me vlerë të bankave, të cilat kryesisht përbëhen nga investimet në letra me vlerë të Qeverisë së Kosovës dhe të qeverive tjera jashtë vendit.

Kriteri i aktivitetit ndërshtetëror dhe kompleksitetit matë shkallën e ndërveprimit të një banke me sektorin e jashtëm si në kuadër të aseteve ashtu dhe në kuadër të detyrimeve si dhe shkallën e kompleksitetit të modelit të biznesit dhe operacioneve të një banke. Ky kriter ka për qëllim të paraqesë nivelin e rrezikut të një banke ndaj ekspozimeve të saj në sektorin e jashtëm dhe nivelin e rrezikut nën supozimin se sa më kompleks aktiviteti i një banke, aq më të shumta janë ndërlidhjet dhe marrëveshjet me palë të treta, të cilat i rrisin kostot dhe kohën e adresimit të problemeve në rast të falimentimit. Kosova vazhdon të ketë nivel mjaft të ulët të ndërveprimit bankar me vendet tjera, andaj është më rezistente ndaj rreziqeve të mundshme të cilat vijnë nga sektori i jashtëm. Si indikator për matjen e aktivitetit ndërshtetëror janë marrë kërkesat dhe detyrimet ndaj jo-rezidentëve ndërsa si indikator i përafërt për matjen e kompleksitetit të një banke është marrë pjesëmarrja e zërave jashtë-bilancorë në gjithsej portfolion e aseteve të asaj banke.

3.1. Rezultatet

Për të vlerësuar qëndrueshmërinë e modelit të identifikimit të bankave me rëndësi sistemike, është vlerësuar rëndësia sistemike duke përdorë pesha të ndryshme për kriteret për përcaktimin e rëndësisë sistemike. Tri versionet e konsideruara janë:

Versioni i parë, i cili iu jep peshë të njëjtë të katër kriterëve për vlerësimin e rëndësisë sistemike.

Versioni i dytë konsideron që kriteri i madhësisë dhe ai i zëvendësueshmërisë kanë rëndësinë më të madhe për identifikimin e bankave me rëndësi sistemike në Kosovë për shkak se sektori është i thjeshtë dhe ekspozimi ndaj institucioneve tjera financiare brenda dhe jashtë vendit është i ulët. Peshat e kriterëve konsiderohen si në vijim: Madhësia 40%; Zëvendësueshmëria 40%; Ndërlidhja 10% dhe Aktiviteti ndërshtetërorë dhe kompleksiteti 10%.

Versioni i tretë i jep rëndësi më të madhe kriterit të madhësisë, me peshë 40%, pasi që sektori bankar në Kosovë është i thjeshtë dhe madhësia është treguesi kryesorë në përcaktimin e rëndësisë sistemike. Kriteri i radhës më i rëndësishëm është ai i zëvendësueshmërisë, i vlerësuar me peshë 30%. Kriteri i ndërlidhjes vlerësohet me peshë 20%, dhe ai i aktivitetit ndër-shtetëror dhe kompleksitetit me peshë 10%.

Rezultatet e të tri versioneve janë të paraqitura në figurën 2. Siç mund të vërehet nga figura, rezultatet janë përgjithësisht të qëndrueshme, në kuptimin se ka dallime të vogla në rëndësinë sistematike të institucioneve.

Në skenarin e parë, me supozimin e peshës së njëjtë për kriteret, kemi pesë banka me rëndësi sistematike. Në skenarin e dytë, në të cilin i japin rëndësi më të madhe dy kriterëve si madhësia dhe zëvendësueshmëria, numri i bankave me rëndësi sistematike bie në katër. Ngjashëm edhe në skenarin e tretë, në të cilin pesha reduktohet gradualisht duke shkuar nga kriteri i madhësisë, zëvendësueshmërisë, ndërlidhjes dhe aktivitetit ndërshtetërorë dhe kompleksitetit, katër bankat e njëjta rezultojnë me rëndësi sistematike.

Ndryshimet në rezultate mund të analizohen përmes analizimit të matricës së ndërlidhjes/korrelacionit ndërmjet kriterëve për vlerësimin e rëndësisë sistematike (Tabela 3). Kriteri i madhësisë tregon korrelacion të lartë me kriterin e zëvendësueshmërisë si dhe atë të aktivitetit ndërshtetëror dhe kompleksitetit, ndërsa korrelacioni me kriterin e ndërlidhjes është më i ulët. Kjo nënkupton që bankat të cilat kanë pjesëmarrje më të lartë të aseteve janë po ashtu bankat të cilat kanë peshë më të madhe në kreditimin e sektorëve kryesorë të ekonomisë, në nivelin e depozitave të ekonomive familjare si dhe në aktivitetin e pagesave. Gjithashtu, kanë pjesëmarrje më të lartë të mjeteve jashtë-bilancore dhe ekspozim në sektorin e jashtëm. Ndërsa, diferenca kryesore qëndron në aspektin e ndërlidhjes me institucione tjera financiare, në të cilin rast ka përjashtime në kuptimin që disa banka më të vogla rezultojnë me pjesëmarrje më të lartë të aseteve dhe detyrimeve ndaj institucioneve tjera financiare. Rrjedhimisht, në skenarin e parë, në të cilin i është dhënë peshë e njëjtë kriterit të ndërlidhjes, si dhe atij të aktivitetit ndërshtetëror dhe kompleksitetit (i cili megjithatë ka korrelacion më të ulët se kriteri i zëvendësueshmërisë), një bankë tjetër më e vogël vjen në shprehje për rëndësinë e saj sistematike.

Figura 2. Rezultatet e tri metodave për matjen e rëndësisë sistematike




Tabela 3. Matrica e ndërlidhjes/korrelacionit ndërmjet të kriterëve për vlerësimin e rëndësisë sistematike

Përshkrimi	Madhësia	Zëvendësueshmëria	Ndërlidhja	Aktiviteti ndërshtetëror/Kompl.
Madhësia	1.0000			
Zëvendësueshmëria	0.9866	1.0000		
Ndërlidhja	0.7236	0.6605	1.0000	
Akt_ndërshtetëror dhe Kompleksiteti	0.9341	0.9104	0.6954	1.0000

Burimi: BQK (2017)

Marrë parasysh rezultatet e mësipërme, si dhe me qëllim të reduktimit të hapësirës për subjektivitet si dhe nënvlerësim të rrezikut si pasojë e evoluimit të sektorit dhe rritjes së

rëndësisë në kriteret të cilave në vazhdimësi iu është dhënë më pak rëndësi (ndërlidhjes dhe kompleksitetit/aktivitetit ndërshtetërorë), konsiderojmë që versioni i peshave të barabarta është më gjithëpërfshirës dhe adekuat për vlerësimin e rëndësisë sistemike. Për më tepër, rezultatet përfundimtare të modelit për qëllime të përcaktimit të kërkesave për kapital shtesë konform rëndësisë sistemike do të shoqërohet me vlerësim dhe gjykim profesional, gjë që do të reduktojë mundësinë e mbivlerësimit të rëndësisë sistemike të ndonjë institucioni.


3.2. Kapitali shtesë për absorbimin e humbjeve

Sipas ABE, qëllimi i rregullativës për identifikimin e institucioneve me rëndësi sistemike vendore është që të iu mundësoj autoriteteve relevante që nën juridiksionin e tyre të kërkojnë nga BRSV-të të mbajnë kapital shtesë deri në 2% të mjeteve të peshuara me rrezik konform nivelit të rëndësisë së tyre sistemike. Ky kapital shtesë do të vepronte si faktor mbrojtës për ruajtjen e stabilitetit të BRSV-ve duke iu mundësuar absorbimin e humbjeve të mundshme si rezultat i ndonjë krize eventuale, si dhe njëkohësisht do të ndihmonte në shmangien e efektit "domino" në sektorin bankar dhe sistemin financiar të vendit.

Sektorin bankar në Kosovë ndër vite ka dëshmuar që është mjaftë mirë i kapitalizuar, ku secila bankë tejkalon kërkesat minimale rregullatore të kapitalit prej 12 përqind (Figura 3). Vendet anëtare të eurozonës kanë nivel më të ulët të kërkesës rregullatore për kapital të klasit të parë (prej 6% Kk1¹³ për dallim nga 8% në Kosovë) dhe aplikimi i shtesave të kapitalit të rekomanduara nga Bazel dhe ABE sërish nuk do ta tejkallonte kërkesën e kapitalit për sektorin bankar në Kosovë.

Megjithatë, BQK, në kuadër të politikës së makroprudencës, mandaton Komitetin e Makroprudencës në monitorimin e vazhdueshëm të gjendjes së sektorit bankar dhe dhënien e rekomandimeve për aplikim të instrumenteve përkatëse kur konsiderohet e nevojshme. Ndër instrumentet e makroprudencës është edhe kapitali shtesë konform rëndësisë sistemike të bankave (SIFI capital surcharges). Rrjedhimisht, marrë parasysh rolin e Komitetit të Makroprudencës dhe me qëllim që të

Figura 3. Norma e kapitalizimit



Burimi: BQK (2017)


jemi më proaktiv ndaj masave që vazhdimisht propozohen nga Bazel, është adoptuar metodologjia e propozuar nga ABE për kalkulim të kapitalit shtesë për bankat me rëndësi sistemike. Duke qenë se metodologjia që do të përdoret nga vendet anëtare të BE-së lë hapësirë për fleksibilitet për të pasqyruar specifikat e sistemeve bankare të vendeve përkatëse, atëherë për rastin e Kosovës është përcaktuar që niveli i kapitalit shtesë të shtrihet nga 0 - 1.0 përqind të mjeteve të peshuara me rrezik varësisht nga rëndësia sistemike e bankave. Duhet theksuar se ky nivel nuk paraqet rekomandim, por është adoptuar dhe modeluar për qëllime të disponueshmërisë së një modeli që mundëson analizimin e adekuatshmërisë së kapitait të bankave individuale duke marrë për bazë rëndësinë e tyre sistemike, si dhe krijon bazën për

¹³ Basel III: A global regulatory framework for more resilient banks and banking systems (December 2010) <http://www.bis.org/publ/bcbs189.pdf>

marrjen e vendimeve për një shtesë eventuale të tillë të kapitalit në pajtueshmëri me politikën makroprudenciale.

Në vijim është përshkrimi i mënyrës së llogaritjes së kapitalit shtesë. Niveli i kapitalit shtesë përcaktohet krahas shkallës së rëndësisë sistemike të secilës bankë. Kufiri i rëndësisë sistemike për sektorin bankar në Kosovë është vlerësuar të jetë 1,000 pikë bazë dhe bankat që kanë shkallë sistemike mbi këtë nivel kategorizohen nëpër nivele (buckets) varësisht nga shakalla e rëndësisë sistemike. Numri i niveleve rekomandohet të jetë baraz ose më i ulët se numri i BRS-ve, me qëllim të krijimit të hapësirës për rritje të mundshme të rëndësisë sistemike.¹⁴

Figura 4. Shkalla e rëndësisë sistemike dhe alokimi i kapitalit shtesë



Burimi: BQK (2017)

Hapat e kalkulimit si në vijim:

- Bankat renditen sipas shkallës së rëndësisë sistemike në renditje rënese (nga më e larta drejt së ultës)
- Shtrirja e shkallës së rëndësisë sistemike për çdo nivel kalkulohet si raport i diferencës së shkallës më të lartë sistemike me shkallën që renditet menjëherë poshtë kufirit të rëndësisë sistemike ndaj n-1 nivele (pasi që niveli i fundit rekomandohet të mbetet i zbrazët për krijimin e hapësirës për rritje të rëndësisë sistemike në të ardhmen).

Në figurën 4, si dhe në tabelën 4 në vijim, paraqiten për qëllime ilustrimi rezultatet e modelit për sektorin bankar të Kosovës me të dhëna të dhjetorit 2016. Rezultatet sugjerojnë që pesë banka kanë rëndësi të përgjithshme sistemike dhe rrjedhimisht nevojë për kapital shtesë. Tri nga këto banka rezultojnë me shkallë të rëndësisë sistemike që kategorizohen në nivelin e parë të shtrirjeve sistemike. Bankat në këtë nivel do të duhej të mbanin kapital shtesë prej 0.25% mbi bazën e kërkuar rregullatore të kapitalit të klasit të parë. Ndërsa dy banka të tjera të cilat rezultojnë me rëndësi sistemike në nivelin e tretë korrespondojnë me 0.75% të kapitalit shtesë që duhet të mbajnë mbi nivelin minimal rregullator të raportit të kapitalit të klasit të parë.

Tabela 4. Shkalla e kapitalit shtesë krahas shtrirjes së rëndësisë sistemike

Nivelet e kapitalit	Shtrirja e rëndësisë sistemike	Kapitali shtesë për absorbim të humbjeve
4	2,830.0 - 3,439.5	+ 1.00% KK1
3	2,220.0 - 2829.6	+ 0.75% KK1
2	1,610.0 - 2,219.7	+ 0.50% KK1
1	1,000.0 - 1,609.9	+ 0.25% KK1

Burimi: BQK (2017)

¹⁴ Nga udhëzimet e FMN dhe Institutit të Bashkuar të Vienës - JVI

IV. Përfundim

Kriza globale financiare e fundit ka theksuar rëndësinë e adresimit të rrezikut sistemik në ruajtjen e stabilitetit financiar, ndaj dhe ka shtyrë në revidimin e rregullave globale dhe nacionale për mbrojtjen nga rreziku sistemik. Shumë shtete hartuan kornizën legislative të Politikës Makroprudenciale me qëllim të krijimit të mekanizmave të cilët rrisin qëndrueshmërinë e sektorit financiar dhe parandalojnë akumulimin e rrezikut sistemik dhe efektet e tij. Një ndër veglat që sugjerohet nga Banka për Ndërmjetësime Ndërkombëtare (angl: *BIS*) në kornizën rregullative të Baselit si dhe nga Bordi i Stabilitetit Financiar (angl: *FSB*) të përdoret për identifikimin dhe adresimin e dimensionit ndër-sektoral dhe strukturorë të rrezikut sistemik është modeli i Institucioneve Financiare me Rëndësi Sistemike (IFRS). Institucionet financiare të cilat janë të mëdha, më komplekse në veprimtarinë e tyre dhe më të ndërlidhura me institucione tjera, duhet të jenë në gjendje të përballojnë goditje të jashtme dhe të absorbojnë humbje pa shkaktuar pengesa në funksionimin e tyre dhe dhënien e shërbimeve financiare, ngase dështimi i tyre mund të sjellë pasoja të mëdha për tërë sektorin dhe ekonominë sidomos në rastet kur nuk janë mirë të kapitalizuara.

Në këtë punim, në përpjekje të avancimit të mjeteve për ruajtje të stabilitetit financiar dhe dhënies së kontributit në operacionalizimin e Politikës makroprudenciale të BQK-së, të aprovuar në vitin 2016, zhvillohet modeli për identifikimin dhe adresimin e IFRS-ve për sektorin bankar të Kosovës. Modeli bazohet në udhëzimet e Autoriteti Bankar Evropian (angl: *EBA*). Përparësia e këtij modeli krahas modeleve paraprake që janë aplikuar nga BQK është se standardizon mënyrën e vlerësimit me kornizën rregullative evropiane dhe vendet anëtare të Bashkimit Evropian dhe lehtëson krahasimin. Kriteret e vlerësimit reduktohen në katër, duke bashkuar kriterin e aktivitetit ndërshtetërorë me atë të kompleksitetit. Pësha e kriterëve është e barabartë, gjë që redukton hapësirën për subjektivitet si dhe eliminon mundësinë e nënvlerësimit të rrezikut si pasojë e evoluimit të sektorit dhe rritjes së rëndësisë në kriteret të cilave në vazhdimësi iu është dhënë më pak rëndësi (ndërlidhjes dhe kompleksitetit/aktivitetit ndërshtetërorë).

Sidoqoftë, për të vlerësuar qëndrueshmërinë e modelit janë shqyrtuar tri versione me peshë të ndryshme për kriteret për përcaktimin e rëndësisë sistemike dhe rezultatet janë përgjithësisht të qëndrueshme me dallime marginale në shkallën e rëndësisë sistemike të institucioneve. Ndryshimet në rezultate analizohen përmes matricës së korrelacionit të kriterëve për vlerësimin e rëndësisë sistemike, me ç'rast kriteri i madhësisë tregon korrelacion të lartë me kriterin e zëvendësueshmërisë dhe kompleksitetit/aktivitetit ndërshtetërorë, ndërsa korrelacion më të ulët me kriterin e ndërlidhjes. Andaj ndryshimi kryesor në rezultate rrjedhë nga fakti që bankat më të vogla karakterizohen me pjesëmarrje më të lartë të aseteve dhe detyrimeve ndaj institucioneve tjera financiare, dhe rrjedhimisht iu rritet rëndësia sistemike kur kriterit të ndërlidhjes i vendoset peshë më e madhe.

Kontributi i këtij punimi qëndron në kalibrimin e modelit për nxjerrjen e rekomandimeve konkrete për shtesën e nevojshme të kapitalit konform rëndësisë sistemike të bankave në sektorin bankar të Kosovës. Niveli i kapitalit shtesë është propozuar të shtrihet nga 0 - 1.0 përqind të mjeteve të peshuara me rrezik varësisht nga rëndësia sistemike e bankave. Megjithëse sektori ka dëshmuar ndër vite që është mjaftë mirë i kapitalizuar dhe aplikimi i shtesave të kapital mbi kapitalin e klasit të parë të rekomanduara nga Bazeli dhe ABE nuk do të tejkalonte nivelin aktual të kapitalit për sektorin bankar në Kosovë, kalibrimi i modelit është në funksion të funksionalizimit të politikës makroprudenciale dhe shërben si instrument për sigurimin në vazhdimësi të adekuatshmërisë së kapitalit si dhe mbikëqyrjen më të informuar dhe adekuate të institucioneve konform rëndësisë së tyre sistemike.

Në kalibrimin e modelit të IFRS-ve për Kosovën, ka devijim nga udhëzimet e ABE në aspektin e vendosjes së kufirit të rëndësisë sistemike. Për Kosovën, marrë parasysh që sektori bankar përfshinë numër relativisht të vogël të bankave krahas vendeve të BE-së, kufiri i rëndësisë sistemike është vendosur më lartë ngase vendosja e kufirit në shkallën e propozuar nga ABE rezultonte që të gjitha bankat në Kosovë të jenë të rëndësishme sistemikisht. Ky adaptim është bërë për t'iu përshtatur kontekstit të Kosovës nën parimin se modeli duhet të komplementohet me gjykim ekspertësh për vlerësimin përfundimtar të rëndësisë sistemike të institucioneve. Në mungesë të informacionit për krahasim të kufirit të rëndësisë sistemike nga vendet e rajonit me sektorë më të ngjashëm me atë të Kosovës, është vështirësuar krahasimi i argumentit të përdorur për vendosjen e kufirit të rëndësisë sistemike, gjë që njëherit paraqet sfidën kryesore për të ardhmen.

Sidoqoftë, duhet theksuar se ky material ka karakter diskutues rreth vlerësimit të adekuatshmërisë së kapitalit të institucioneve bankare në Kosovë, dhe nuk parqet rekomandim për ndërmarrjen e masave për kapital shtesë të rëndësisë sistemike. Në këtë material është paraqitur gjendja aktuale në sektorin bankar në vend, udhëzimet rregullative që propozohen nga autoritetet rregullative të sektorit bankar në vendet e BE-së, në mënyrë që të përcillet më me kujdes ecuria e performimit të BRS-ve dhe të diskutohet rreth aftësisë së tyre për ndarje të kapitalit dhe/ose përballimit të humbjeve eventuale. Prandaj ky material diskutues shërben si bazë e mirë për diskutim dhe avancim të supozimeve dhe gjykimit profesional të aplikuar në përcaktimin përfundimtar të rëndësisë sistemike të bankave që operojnë në Kosovë.

Propozohet që në të ardhmen të analizohet rëndësia sistemike e bankave duke marrë për bazë edhe efektin 'informues' të shpërndarjes së problemeve, i cili nuk modelohet në kornizën ekzistuese të identifikimit të BRS-ve. Sektori bankar relativisht i vogël në Kosovë, dhe faza e hershme e zhvillimit të institucioneve për adresimin e krizave, e rritë peshën e kanalit informues të shpërndarjes së krizës dhe rrjedhimisht rezulton në rritjen e rëndësisë sistemike edhe për banka tjera të cilat modeli ekzistues nuk i identifikon si të tilla.

Referencat

- Banka Qendrore Evropiane (BQE).** www.ecb.europa.eu/ecb/tasks/stability/html/index.en.html
- Bank of England (2016).** The Financial Policy Committee's framework for the systemic risk buffer, <http://www.bankofengland.co.uk/financialstability/Pages/fpc/systemicrisk.aspx>
- Berg, S.A. (2011).** Systemic surcharges and measures of systemic importance. *Journal of Financial Regulation and Compliance* 19, pp. 383-395.
- Biasis, D., Flood, M., Lo, A.W., and Valavanis, S. (2012).** A survey of systemic risk analytics. U.S. Department of Treasury, *Office of Financial Research Working paper No. 0001*.
- BIS. (2013).** Basel III: Global systemically important banks: updated assessment methodology and the higher loss absorbency requirement, *Basel Committee on Banking Supervision*, updated version as of July 2013.
- BIS. (2012).** A framework for dealing with domestic systemically important banks, Basel Committee on Banking Supervision, Consultative Document, June 2012.
- BIS. (2011).** Basel III: A global regulatory framework for more resilient banks and banking systems. *Basel Committee on Banking Supervision*, December 2010.
- Bongini, P. and Nieri, L. (2014).** Identifying and Regulating Systemically Important Financial Institutions. *Economic Notes by Banca Monte dei Paschi di Siena SpA*, vol. 43, no. 1-2014: pp. 39–62
- BQK. (2014).** Identifikimi i Bankave me Rëndësi Sistemike, *Raporti i Stabilitetit Financiar Nr.4*, fq. 61.
- BQK. (2016).** Identifikimi i Bankave me Rëndësi Sistemike, *Raporti i Stabilitetit Financiar Nr.9*, fq. 75.
- De-Bandt, O. and Hartmann, P. (2000).** Systemic risk: A survey. *ECB Working Paper No. 35*.
- Dijkman, M. (2010).** A framework for assessing systemic risk. *World Bank Policy Research Working Paper No. 5282*.
- EBA. (2014).** Guidelines on the criteria to determine the conditions of application of Article 131(3) of Directive 2013/36/EU (CRD) in relation to the assessment of other systemically important institutions (O-SIIs), European Banking Authority, December.
- ECB. (2009).** The concept of systemic risk. *Financial Stability Review*, December, 134.
- ESRB. (2013).** Intermediate objectives and instruments of macro-prudential policy, Recommendation of the European Systemic Risk Board. *Official Journal of the European Union*, 4 April.
- Elliott, D.J. and Litan, R.E. (2011).** Identifying and regulating systemically important financial institutions: The risks of under and over identification and regulation. *Working paper*, Brookings Institutions.
- FSB. (2011).** Policy Measures to Address Systemically Important Financial Institutions, *Financial Stability Board*, 4 November. http://www.fsb.org/2011/11/r_111104bb/
- FSB. (2010).** Reducing the moral hazard posed by systemically important financial institutions. *FSB Recommendations and Time Lines*, 20th October.

https://www.ecb.europa.eu/press/key/date/2009/html/sp091210_1.en.html

Kastrati, A. (2012). Identifikimi i bankave me rëndësi sistemike në Kosovë. *Raporti i Stabilitetit Financiar* Nr.3. Banka Qendrore e Kosovës.

Komárková, Z., Hausenblas, V. and Frait, J. (2012). How to identify systemically important financial institutions. *Financial Stability Report 2011/2012*, pp. 100-111, Czech National Bank.

Laeven, L., Ratnovski, L., and Tong, H. (2014). Bank size and systemic risk. *IMF Staff Discussion Note SDN/14/04*.

Silva, W., Kimura, H. and Sobreiro, V. A. (2016). An analysis of the literature on systemic financial risk: A survey. *Journal of Financial Stability* 28, pp. 91-114.

Smaga, P. (2014). The concept of systemic risk. *Systemic Risk Centre Special Paper No. 5*, London School of Economics and Political Sciences. London, UK.

Trichet, J-C. (2009). Systemic risk. Clare Distinguished Lecture in Economics and Public Policy, University of Cambridge, 10 December.

Thomson, J. B. (2009). On Systemically Important Financial Institutions and progressive systemic mitigation. *Policy Discussion Paper No. 27*, Federal Reserve Bank of Cleveland.



Rr. Garibaldi, nr.33, 10000 Prishtinë,
Republika e Kosovës
Tel: +381 38 222 055; Fax: +381 38 243 763
Web: www.bqk-kos.org